Nr. 233 prot. Datë 15.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË**

**VENDIM**

Nr. 25, datë 13.10.2025

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM BURIMI UJOR PËR NDËRTIMIN, RINDËRTIMIN, APO SHEMBJEN PËR MBROJTJEN E BRIGJEVE, MUREVE, PRITAVE E VEPRAVE TË TJERA NË BRIGJE, ME VENDNDODHJE LUMI DRIN, BASHKIA VAU-DEJËS TË SUBJEKTIT BASHKIA VAU-DEJËS.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, *"Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre"*, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës "Për autorizim për përdorim burimi ujor për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje", të subjektit Bashkia Vau-Dejës, me vendndodhje lumi Drin, Bashkia Vau-Dejës, me arsyetimin që Bashkia Vau-Dejës duhet të rrakordojë me Bashkinë Shkodër për ndërtimin e strukturave (argjinaturave) në ketë segment të Lumit Drin pasi ky lum në segmentin e propozuar është kufiri administrativ i këtyre dy bashkive.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i trupit ujor: Lumi Drin.

Koordinatat e konturit të mbrojtjes lumore (KRGJSH)

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | X=466825; | Y=4651985; | Z=20.23 |
| 2. | X=466667; | Y=4652188; | Z=21.20 |
| 3. | X=466880; | Y=4652362; | Z=27.37 |
| 4. | X=466790; | Y=4651955; | Z=20.12 |
| 5. | X=466600; | Y=4652157; | Z=20.85 |
| 6. | X=465998; | Y=4651771; | Z=19.74 |
| 7. | X=465064; | Y=4651230; | Z=19.72 |
| 8. | X=464149; | Y=4651523; | Z=19.44 |
| 9. | X=464350; | Y=4652039; | Z=17.70 |
| 10. | X=464258; | Y=4652323; | Z=17.39 |
| 11. | X=463484; | Y=4652815; | Z=16.49 |
| 12. | X=462998; | Y=4653058; | Z=18.79 |

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit Bashkisë Vau Dejës.

**KRYETARI I KBL DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT LUMOR - DRIN-BUNË